

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-T

Data: 26 janar 2012

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Urdhër: 26 janar 2012

**PROKURORI
k.**

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI MOCIONIN E PROKURORISË PËR PRANIMIN E PROVAVE
NË SALLËN E GJYQIT, NDRYSHIMIN E LISTËS SË DËSHMITARËVE DHE
PROVAVE MATERIALE TË RREGULLËS 65 TER DHE PRANIMIN E
PROVAVE SIPAS RREGULLËS 92 TER**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

I. HISTORIA PROCEDURALE

KJO DHOMË GJYQËSORE e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 (“Tribunali”) ka marrë “Mocion i Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65 *ter* dhe pranimin e provave sipas Rregullës 92 *ter*”, paraqitur publikisht së bashku me shtojcat publike A dhe B më 5 tetor 2011 (“Mocioni”), në të cilin Prokuroria kërkon:

- (1) leje për tejkalimin e kufizimit të numrit të fjalëve parashtruar në Udhëzuesin Praktik;¹
- (2) leje për përfshirjen e Marlène Schnieper-it në listën e dëshmitarëve të Prokurorisë të Rregullës 65*ter* dhe për thirrjen e saj si dëshmitare sipas Rregullës 92*ter* të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”);
- (3) pranimin e deklaratës me shkrim të Marlène Schnieper-it (dokument i Rregullës 65*ter* numër 3111) pas përmbushjes së kushteve të Rregullës 92*ter*(A), pranimin e intervistës me Ramush Haradinajn (dokument i Rregullës 65*ter* numër 3000) si provë materiale që lidhet me deklaratën me shkrim të Marlène Schnieper-it, dhe leje për t’i bërë asaj një numër të kufizuar pyetjesh;²
- (4) leje për përfshirje të një kopjeje të nënshkruar të librit *Rrëfim për Luftën dhe Lirinë* dhe të letrës së Mbrojtjes së Haradinajt të datës 9 janar 2007 (dokumente të Rregullës 65*ter* me numër 3112 dhe 3113) në Listën e Rregullës 65 *ter* të provave të Prokurorisë, dhe për rishikimin dhe plotësimin e dokumenteve të Rregullës

¹ It/184 Rev. 2, Udhëzuesi praktik për gjatësinë e dosjeve dhe mocioneve, 16 shtator 2005 9 (“Udhëzuesi Praktik”), para. 5.

² Mocioni, para. 3, 31.

65ter numër 1276, dokumente këto të marra nga faqja e internetit e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (“KNKK”);³

(5) pranimin si provë në sallën e gjyqit të dokumentacionit mjeko-ligjor (dokumente të Rregullës 65ter me numrat 3060-3064), të pjesëve të librit të lartpërmendur (Rregulla 65ter, numër 3002) të paraqitura në Shtojcën A të Mocionit, dhe të dokumenteve të Rregullës 65ter me numër 1276 dhe 3113;⁴

(6) ndryshe, në qoftë se Dhoma do të refuzojë kërkesën për përfshirjen e Schnieper-it në listën e dëshmitarëve të Prokurorisë, të pranohet si provë në sallën e gjyqit dokumenti i Rregullës 65ter me numër 3000.⁵

2. Më 19 tetor 2011, Haradinajt paraqiti ‘Përgjigje në emër të Ramush Haradinajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65 ter dhe pranimin e provave sipas Rregullës 92 ter’ (“Përgjigje e Haradinajt”) në të cilën kundërshton Mocionin dhe kërkon leje për tejkalimin e kufizimit të numrit të fjalëve.⁶ Në të njëjtën ditë dhe më 20 tetor 2011, Balaj dhe Brahimaj iu bashkuan Përgjigjes së Haradinajt.⁷

3. Më 26 tetor 2011, Prokuroria paraqiti publikisht “Kërkesë e Prokurorisë për leje për t’u Kundërpërgjigjur dhe për Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Haradinajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, ndryshimin e listës së

³ Mocioni, para. 1, 3, 14, 31.

⁴ Mocioni, para. 1, 14, 31.

⁵ Mocioni, para. 4, 32.

⁶ Përgjigje e Haradinajt, para. 1, sh. 1, para. 2, 34. Përgjigjja e Haradinajt fillimisht u dorëzua publikisht, por në kërkesë të dorëzuesit, më 26 tetor 2011 statusi i saj u ndryshua në konfidencial.

⁷ Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Bashkim i Përgjigjes së Idriz Balajt me “Përgjigje në emër të Ramush Haradinajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65 ter dhe pranimin e provave sipas Rregullës 92 ter”, 19 tetor 2011 (“Përgjigje e Balajt”), para. 3, 6; Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Bashkim i Përgjigjes së Lahi Brahimajt me “Përgjigje në emër të Ramush Haradinajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65 ter dhe pranimin e provave sipas Rregullës 92 ter”, 20 tetor 2011 (“Përgjigje e Brahimajt”), para. 3.

dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65 *ter* dhe pranimin e provave sipas Rregullës 92 *ter*” (‘Kundërpërgjigje’). Prokuroria kërkoi leje për t’iu kundërpërgjigjur përgjigjeve të Haradinajt dhe Balajt dhe bëri të ditur se Përgjigjja e Balajt ishte dorëzuar jashtë afatit 14-ditor sipas Rregullës 126*bis* të Rregullores, dhe i kërkoi Dhomës që të miratonte Mocionin e saj.⁸

4. Më 2 nëntor 2011, Palët paraqitën parashtrim të përbashkët për pranimin prej tyre të katër fakteve mjeko-ligjore në lidhje me vdekjen e Pal Krasniqit.⁹ Rrjedhimisht, në të njëjtën ditë Prokuroria tërhoqi kërkesën e saj për pranimin e dokumentit të Rregullës 65*ter* numër 3064 - aktautopsia në lidhje me vdekjen e Pal Krasniqit.¹⁰

II. PARASHTRIMET

A. Mocioni

5. Prokuroria kërkon leje për përfshirjen e gazetares zvicerane Marlène Schnieper në listën e saj të dëshmitarëve.¹¹ Në rast të miratimit të kësaj kërke, Prokuroria kërkon leje për paraqitjen e dëshmisë së Schnieper-it sipas Rregullës 92*ter* dhe planifikon të paraqesë si provë shoqëruese procesverbalin e intervistës së Schnieper-it me Ramush Haradinajn (“Intervista”) i cili është përfshirë në listën e provave të Prokurorisë si dokument i Rregullës 65*ter* numër 3000.¹² Prokuroria pretendon se deklarata si dëshmitare e Schnieper-it (dokument i Rregullës 65*ter* numër 3111) është e rëndësishme për arsye se vërteton procesverbalin e Intervistës.¹³ Prokuroria gjithashtu kërkon që të lejohet t’i bëjë Schnieper-it një numër të kufizuar pyetjesh, që nuk do të zgjasin më shumë se 45

⁸ Kundërpërgjigje, para. 1, 15.

⁹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84*bis*-T, Parashtrim i përbashkët i Prokurorisë dhe Mbrojtjes në lidhje me fakte të pranuar nga Palët, me Shtojcën A, 2 nëntor 2011 (Fakte të pranuar nga Palët në lidhje me vdekjen e Palë Krasniqit), para. 1, Shtojca.

¹⁰ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84*bis*-T, Parashtrim i Prokurorisë për tërheqjen e kërkesës për pranimin si provë të dokumentit të Rregullës 65*ter* numër 3064, 2 nëntor 2011.

¹¹ Mocioni, para.3.

¹² Mocioni, para.3.

¹³ Mocioni, para. 3, 26; *shih* Kundërpërgjigje, para. 9.

minuta.¹⁴ Këtë e kërkon për të vërtetuar se pas intervistës, Haradinaj i dha Schnieper-it një kopje të një libri të nënshkruar me dedikim prej tij.¹⁵ Prokuroria mori kopjen e nënshkruar me dedikim të librit më 27 shtator 2011 dhe kërkon që ajo të përfshihet në listën e provave materiale si dokument i Rregullës 65ter me numër 3112.¹⁶ Prokuroria parashtron se ekziston arsye e fortë për përfshirjen e Schnieper-it në listën e dëshmitarëve dhe të kopjes së librit të nënshkruar me dedikim në listën e provave materiale në këtë fazë të gjyimit, meqenëse kjo do t'i mundësonte Dhomës të dëgjonte këtë dëshmi të rëndësishme dhe për arsye se Haradinaj ndryshoi mendim në lidhje me besueshmërinë dhe pranueshmërinë si provë të këtij libri, dhe tani e kundërshton atë.¹⁷ Prokuroria më tej parashtron se kjo nuk do ta paragjykonte padrejtësisht të Akuzuarin duke qenë se dëshmia e Schnieper-it është e kufizuar; i Akuzuari e ka pasur deklaratën e saj që nga 24 shkurti 2006, kurse procesverbalin e Intervistës që nga 15 shkurti 2006.¹⁸ Prokuroria argumenton se në këto rrethana, përfshirja e Schnieper-it dhe e librit të nënshkruar në listën e dëshmitarëve dhe të provave nuk do të shkaktoje stërzgjatje të procesit dhe i Akuzuari do të ketë kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur.¹⁹ Prokuroria më tej parashtron se Intervista është e rëndësishme dhe ka vlerë provuese lidhur me akuzat e ngritura në Aktakuzë, se Dhoma Gjyqësore gjatë gjyimit të parë gaboi kur e refuzoi atë, dhe se riparaqitja e saj për pranim nuk do ta paragjykonte padrejtësisht të Akuzuarin.²⁰

6. Për sa i përket dokumentit të Rregullës 65ter me numër 3002 i cili përmban pjesë të librit të Bardh Hamzajt me titull *Rrëfim për Luftën dhe Lirinë (Dialog me Komandantin Ramush Haradinaj)* ("Libri"), Prokuroria parashtron se libri duhet të pranohet për arsye se shtjellon çështjet e mëposhtme dhe rrjedhimisht është i rëndësishëm dhe ka vlerë provuese lidhur me akuzat e paraqitura në Aktakuzë: pushtetin e Haradinajt, duke përfshirë bashkëpunimin e tij të ngushtë me dy të Akuzuarit e tjerë dhe pushtetin e tij mbi ta, dhe rolin e tij brenda UÇK-së; pushtetin e Brahimajt; çështje të rëndësishme për vërtetimin e ekzistencës së NPK-së së pretenduar; pjesëmarrjen e të Akuzuarve në

¹⁴ Mocioni, para. 3, 27, 30.

¹⁵ Mocioni, para. 3, 27.

¹⁶ Mocioni, para. 1, 27, 31.

¹⁷ Mocioni, para. 28.

¹⁸ Mocioni, para. 29.

¹⁹ Mocioni, para. 29-30.

²⁰ Mocioni, para. 26-27.

NPK dhe përgjegjësinë e tyre bazuar në format e tjera të përgjegjësisë të pretenduara në Aktakuzë.²¹ Për më tepër, Prokuroria parashtron se pjesët e paraqitura të librit duhet të pranohen dhe atyre duhet t'u jepet pesha e duhur duke qenë se në letrën e 9 shkurtit 2007 (dokumenti numër 3113 i Rregullës 65ter, "Letra"), përmes avokatit të tij, Haradinaj e pranoi besueshmërinë dhe autenticitetin e tërë Librit. Ai më tej pranoi se Libri përmban një përmbledhje intervistash me të.²² Duke marrë parasysh faktin se tani Haradinaj e kundërshton autenticitetin dhe pranueshmërinë e Librit si në Dosjen e tij Paragjyqësore, po ashtu edhe gjatë fjalës hyrëse të Prokurorisë, Prokuroria parashtron se Dhoma duhet të miratojë kërkesën e Prokurorisë për përfshirjen e Letrës në listën e provave materiale dhe ta pranojë atë si provë së bashku me pjesët e Librit.²³ Prokuroria më tej pohon se Letra është bazë e mjaftueshme për pranimin e pjesëve të paraqitura të Librit.²⁴ Sipas Prokurorisë autenticiteti i Librit konfirmohet gjithashtu nga fakti se gjatë intervistës me Schnieper-in, Haradinaj e pranoi se ishte Libri i tij dhe iu referua si "libri im".²⁵

7. Meqenëse Libri nuk u pranua si provë gjatë gjykimit të parë, Prokuroria parashtron se sipas vendimit të Dhomës së Apelit,²⁶ vendimet në lidhje me provat të marra gjatë gjykimit të parë nuk janë detyruese për Dhomën në rigjykim.²⁷ Sipas Prokurorisë, Dhoma e rigjykimit duhet vetëm të përcaktojë nëse riparazitja e ndonjë prove për pranim do ta paragjykonte padrejtësisht të Akuzuarin.²⁸ Prokuroria parashtron se riparazitja e Librit për pranim si provë nuk do ta paragjykonte padrejtësisht të Akuzuarin.²⁹ Ajo pohon se në të kundërtën, mospranimi i pjesëve të paraqitura të Librit do të dëmtonte interesat e drejtësisë për arsye se do të përjashtojë një provë shumë e rëndësishme dhe me vlerë provuese që vjen drejtpërsëdrejti nga Haradinaj.³⁰ Prokuroria

²¹ Mocioni, para. 1, 12, Shtojca A.

²² Mocioni, para. 1, 12-14, 28, Shtojca B (dokument i Rregullës 65ter numër 3113), f. 2.

²³ Mocioni, para. 1, 14-15.

²⁴ Mocioni, para. 15.

²⁵ Mocioni, para. 15, 27.

²⁶ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-AR73.1, Vendim mbi Apelin e Haradinajt në lidhje me kuadrin e rigjykimit të pjesshëm, 31 maj 2011, para.25-26.

²⁷ Mocioni, para. 16.

²⁸ Mocioni, para. 17.

²⁹ Mocioni, para. 17.

³⁰ Mocioni, para. 17.

argumenton se vendimi i gjykimit të parë për mospranimin e Librit si provë materiale ishte thjesht i gabuar dhe se Dhoma nuk duhet të mbështetet mbi të.³¹

8. Për sa i përket numrit 1276 të Rregullës 65ter, Prokuroria pohon se këto janë dokumente nga faqja e internetit e KNKK-së të cilat konfirmojnë se pesë viktimat e përmendura në Pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës konsiderohen të zhdukur deri më sot, si dhe datën dhe vendin ku viktimat janë parë për herë të fundit.³² Prokuroria pretendon se dokumentet kanë vlerë të mjaftueshme provuese dhe se autenticiteti i tyre nuk është aspak i dyshimtë meqenëse janë dokumente të marra nga faqja e internetit e KNKK-së.³³ Në lidhje me kërkesën e saj për rishikimin dhe plotësimin e dokumenteve të Rregullës 65ter numër 1276, Prokuroria argumenton se dokumentet e Rregullës 65ter numër 1276 që u paraqitën gjatë gjykimit të parë përmbanin informacion në lidhje me Ivan Zariqin dhe Agron Berishën të aktualizuar për herë të fundit më 29 maj 2006.³⁴ Tani ajo kërkon leje që t'i zëvendësojë ato me versione më të aktualizuara (të datës 31 dhjetor 2010) nga e njëjta faqe interneti. Prokuroria gjithashtu kërkon që të paraqesë dokumente të reja nga faqja e internetit e KNKK-së në lidhje me Nesret Alijajn, Burim Bejtën dhe Ukë Rexhepajn, viktima të përmendura në Pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës.³⁵ Ajo argumenton se përfshirja e këtyre dokumenteve është e arsyeshme për shkak se është e dobishme për Dhomën të ketë informacionin e fundit në lidhje me viktimat nga Pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës.³⁶ Prokuroria parashtron se kjo nuk do t'i paragjykonte të Akuzuarit për arsye se informacioni në lidhje me Ivan Zariqin dhe Agron Berishën nuk ka ndryshuar, kurse dokumentet në lidhje me Nesret Alijajn, Burim Bejtën dhe Ukë Rexhepajn konfirmojnë dëshmitë që janë pjesë e dokumentacionit gjyqësor të rigjykimit.³⁷

9. Prokuroria më tej kërkon pranimin si provë materiale të dokumenteve të Rregullës 65ter me numër 1276, 3060, 3061, 3062 dhe 3063, bazuar në Rregullën 899C) të

³¹ Mocioni, para. 18.

³² Mocioni, para. 1, 21.

³³ Mocioni, para. 22.

³⁴ Mocioni, para. 1, 23.

³⁵ Mocioni, para. 23-24.

³⁶ Mocioni, para. 24.

³⁷ Mocioni, para. 24.

Rregullores.³⁸ Ajo parashtroi se dokumentet e paraqitura i plotësojnë kushtet e pranimit për shkak se janë të rëndësishme dhe me vlerë provuese, dhe se pranimi i tyre në sallën e gjyqit është në interes të kursimit të burimeve të gjykatës.³⁹ Prokuroria parashtroi se dokumentet e Rregullës 65ter me numër 3060 dhe 3063 janë dokumente mjeko-ligjore zyrtare të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK”) që konfirmojnë shkakun e vdekjes së Zenun Gashit, vdekja e të cilit, për mendimin e Prokurorisë është e rëndësishme për vërtetimin e qëllimit të përbashkët të NPK-së.⁴⁰ Prokuroria më tej parashtroi se dokumentet janë të një burimi zyrtar dhe se për këtë arsye besueshmëria e tyre është dukshëm e qartë.⁴¹ Sipas Prokurorisë, gjatë gjykimit të parë të çështjes *Haradinaj dhe të tjerët*, Palët ranë dakord në lidhje me shkakun e vdekjes së Zenun Gashit gjë që shmangu nevojën për të paraqitur dokumente të tjera bazë.⁴² Megjithatë, ndonëse gjatë rigjykimit Prokuroria dhe Mbrojtja arritën marrëveshje për faktet në lidhje me vdekjen e Pal Krasniqit, këtë nuk arritën ta bëjnë për faktet në lidhje me vdekjen e Zenun Gashit.⁴³ Prokuroria pretendon se për këtë arsye, dokumentet e Rregullës 65ter me numër 3060 - 3063 duhet të pranohen si prova materiale në sallë të gjyqit, duke qenë se ato nuk u kundërshtuan gjatë gjykimit të parë dhe për pasojë në listën e dëshmitarëve nuk u përfshinë dëshmitarë përmes të cilëve dokumentet e Rregullës 65ter me numër 3060-3063 do të mund të paraqiteshin si prova.⁴⁴

B. Përgjigjja e Haradinajt

10. Sipas Haradinajt, asnjë pjesë e Librit nuk duhet të pranohet si provë materiale në sallë të gjyqit për arsye se ato përmbajnë deklarata bazuar në burime të dorës së dytë, dhe se asgjë në deklaratën e Schnieper-it ose provat e tjera që i janë paraqitur Dhomës nuk konfirmojnë përmbajtjen e Librit. Sipas tij, Schnieper-i nuk mund të dëshmojë në lidhje me vërtetësinë e përmbajtjes së Librit, ose si është shkruar dhe çfarë burimesh janë

³⁸ Mocioni, para. 1, 31.

³⁹ Mocioni, para. 1-2, 19-22.

⁴⁰ Mocioni, para. 1, 19.

⁴¹ Mocioni, para. 19.

⁴² Mocioni, para. 20.

⁴³ Mocioni, para. 20, Fakte të pranuar nga Palët në lidhje me vdekjen e Pal Krasniqit.

⁴⁴ Mocioni, para. 20.

shfrytëzuar.⁴⁵ Haradinaj më tej parashtroi se Prokuroria nuk paraqiti asnjë provë në mbështetje të kuadrit dhe rrethanave në të cilat është përmendur informacioni në pjesët e Librit, se cili ishte burimi i informacionit, si u hartua ai dhe për çfarë qëllimi.⁴⁶ Haradinaj gjithashtu parashtroi se ai nuk është autor i Librit dhe se nuk ka prova që pjesët e paraqitura të Librit vënë në dukje miratimin e tij të plotë apo të pjesshëm të përmbajtjes së Librit.⁴⁷ Sipas parashtrimeve të Haradinajt, nuk ka prova që do të vërtetonin se Libri, edhe pse bazohet në intervistat me të, reflekton fjalët e tij apo mendimin e autorit të Librit, nëse përmbajtja e librit është e vërtetë ose jo, apo thjesht e shtrembëruar për qëllime propagandistike dhe politike.⁴⁸ Për këto arsye, Haradinaj parashtroi se Prokuroria nuk i plotësoi kushtet e pranueshmërisë së Librit si provë dhe nuk vërtetoi *prima facie* besueshmërinë e tij.⁴⁹

11. Në lidhje me Letrën, Haradinaj pretendon se ajo u shkrua në kuadër të diskutimeve të vazhdueshme “pa paragjykitime” midis Palëve për pranimin e mundshëm të fakteve para fillimit të gjyqimit të parë, të cilat nuk përfunduan në ndonjë marrëveshje për pranimin e fakteve.⁵⁰ Haradinaj pretendon se Mbrojtja kundërshtoi çdo pranim të fakteve bazuar në Librin dhe pranueshmërinë e Librit.⁵¹ Ai më tej parashtroi se Dhoma në gjykimin e parë nuk e pranoi Librin si provë për arsye se gjatë gjyqimit nuk u paraqitën prova të tjera që do të vërtetonin besueshmërinë dhe vërtetësinë e përmbajtjes së Librit.⁵² Sipas Haradinajt, që në fillim të rigjyqimit ai e bëri të qartë se e kundërshton pranimin e Librit si provë.⁵³ Për më tepër, Haradinaj parashtroi se, edhe sikur të presupozohet se Letra tregon që Haradinaj dha pëlqimin për pranimin e Librit si provë (gjë që ai e kundërshton), në bazë të arsyetimit të vetë Prokurorisë, vendimet e marra gjatë gjyqimit të parë nuk janë detyruese për Dhomën dhe Palët të cilat gjatë rigjyqimit mund të ndryshojnë qëndrimin e tyre.⁵⁴ Haradinaj gjithashtu parashtroi se Prokuroria nuk

⁴⁵ Përgjigje e Haradinajt, para. 3-4, 16-17, 19, 24, 26.

⁴⁶ Përgjigje e Haradinajt, para. 4, 17, 25-26.

⁴⁷ Përgjigje e Haradinajt, para. 4, 25.

⁴⁸ Përgjigje e Haradinajt, para. 4, 19, 25-26.

⁴⁹ Përgjigje e Haradinajt, para. 4, 25-26.

⁵⁰ Përgjigje e Haradinajt, para. 27.

⁵¹ Përgjigje e Haradinajt, para. 27-28.

⁵² Përgjigje e Haradinajt, para. 27.

⁵³ Përgjigje e Haradinajt, para. 28.

⁵⁴ Përgjigje e Haradinajt, para. 28.

arriti të shpjegonte se pse nuk e kishte përfshirë Letrën në listën e provave që më parë, dhe se Letra nuk e ndihmon kërkesën e Prokurorisë për pranimin e Librit si provë në sallën e gjyqit.⁵⁵

12. Haradinaj pretendon se gjatë Intervistës, ai e përmendi vetëm një herë Librin si “libri im”, gjatë diskutimit të sulmit kundër familjes së tij në mars 1998.⁵⁶ Sipas tij, kjo nuk ndihmon në zbulimin e së vërtetës apo të besueshmërisë dhe vërtetësisë së cilësdo pjese të Librit që Prokuroria kërkon të paraqesë si provë.⁵⁷ Haradinaj parashtrohet se dedikimi i shkurtër që ai shkroi në Libër për Schnieper-in nuk vërteton se ai e pranoi përmbytjen e Librit apo të ndonjë pjese të veçantë të tij.⁵⁸ Haradinaj argumenton se nuk ka asnjë provë tjetër në deklaratën e Schnieper-it apo në provat e tjera shoqëruese në mbështetje të parashtimit të Prokurorisë për pranueshmërinë e Librit.⁵⁹ Ai pretendon se dëshmia e Schnieper-it nuk lidhet me asnjë aspekt tjetër të rigjykimit.⁶⁰ Ai gjithashtu argumenton se Prokuroria nuk dha shpjegim të arsyeshëm për pranimin e dëshmitares dhe provave të reja në këtë fazë të vonshme.⁶¹ Sipas tij, Prokuroria e dinte qëndrimin e Mbrojtjes në lidhje me pranueshmërinë e Librit që para fillimit të rigjykimit, dhe e njëjtte këtë dëshmitare që nga viti 2005.⁶² Haradinaj pretendon se Prokuroria nuk ka treguar zellin e duhur për marrjen e kësaj dëshmie.⁶³ Sipas tij, në qoftë se Prokurorisë do t'i lejohej vazhdimisht që të përfshinte dëshmitarë të tjerë në listën e dëshmitarëve, procesi gjyqësor do të stërzgjatej dhe kjo do të dëmtonte në mënyrë të pajustificuar të drejtën e të Akuzuarit për gjykim të shpejtë.⁶⁴

13. Sipas Haradinajt, me paraqitjen e Fakteve të Pranuara nga Palët në lidhje me vdekjen e Pal Krasniqit, nuk është e nevojshme të pranohen si prova në sallën e gjyqit dokumentet e Rregullës 65^{ter} me numër 3062-3063 mbi të cilat bazohen faktet e

⁵⁵ Përgjigje e Haradinajt, para. 29.

⁵⁶ Përgjigje e Haradinajt, para. 17, 20.

⁵⁷ Përgjigje e Haradinajt, para. 17.

⁵⁸ Përgjigje e Haradinajt, para. 18.

⁵⁹ Përgjigje e Haradinajt, para. 19-20.

⁶⁰ Përgjigje e Haradinajt, para. 16, 22.

⁶¹ Përgjigje e Haradinajt, para. 13, 21-22.

⁶² Përgjigje e Haradinajt, para. 14, 21.

⁶³ Përgjigje e Haradinajt, para. 16, 22.

⁶⁴ Përgjigje e Haradinajt, para. 22.

pranuara,⁶⁵ Haradinaj kundërshton pranimin në sallën e gjyqit të dokumentacionit mjeko-ligjor në lidhje me vdekjen e Zenun Gashit për arsye se, për mendimin e tij vdekja e Zenun Gashit nuk lidhet me asnjë nga pikat e rigjykimit.⁶⁶ Për sa u përket dokumenteve të Rregullës 65ter me numër 1276, Haradinaj pretendon se ato përmbajnë thjesht informacion nga interneti që nuk është konfirmuar nga ndonjë dëshmitar. Ai pretendon se në lidhje me viktimat e pretenduara, Dhoma tashmë ka marrë informacion nga anëtarët e familjeve të tyre.⁶⁷

C. Përgjigjet e Balajt dhe Brahimajt

14. Balaj dhe Brahimaj iu bashkuan Përgjigjes së Haradinajt duke i pranuar të gjitha argumentet e paraqitura në të.⁶⁸ Balaj kundërshton rëndësinë e Zenun Gashit për këtë rigjykim.⁶⁹ Ai gjithashtu parashtron se Prokuroria nuk vërtetoi që pranimi i kësaj dëshmie nuk do të paragjykonte të Akuzuarit.⁷⁰

D. Kundërpërgjigjja e Prokurorisë

15. Prokuroria pretendon se parashtrimet në Përgjigjen e Haradinajt bien ndesh me deklaratën e tij në Letrën lidhur me pranueshmërinë e Librit.⁷¹ Sipas Prokurorisë, në Letër nuk ka asgjë që do të sugjeronte se pranimi i autenticitetit dhe pranueshmërisë së Librit përbën “padrejtësi”. Ajo pretendon se për të mos e penguar punën e Tribunalit në zbulimin e së vërtetës, pranimi i Letrës si provë nuk mund të tërhiqet për shkak të ndryshimit të strategjisë gjyqësore të Mbrojtjes.⁷² Prokuroria më tej parashtron se në Letër, Mbrojtja e Haradinajt theksonte se nuk kishte nevojë për një marrëveshje formale në lidhje me pranueshmërinë e Librit në gjykimin e parë, për arsye se Haradinaj nuk e

⁶⁵ Përgjigje e Haradinajt, para. 31; Fakte të pranuar nga Palët në lidhje me vdekjen e Pal Krasniqit

⁶⁶ Përgjigje e Haradinajt, para. 32.

⁶⁷ Përgjigje e Haradinajt, para. 33.

⁶⁸ Përgjigje e Balajt, para. 3, 6; Përgjigje e Brahimajt, para. 3.

⁶⁹ Përgjigje e Balajt, para. 4.

⁷⁰ Përgjigje e Balajt, para. 5.

⁷¹ Kundërpërgjigje, para. 2-3.

⁷² Kundërpërgjigje, para. 4.

kundërshtonte autenticitetin dhe pranueshmërinë e tij.⁷³ Prokuroria më tej bën të ditur se më pas gjatë gjykimit të parë, Haradinaj nuk paraqiti kurrfarë përgjigje ndaj mocionit të Prokurorisë për pranimin e Librit si provë materiale, për arsye se Dhoma i kishte njoftuar Palët që nuk do ta pranonte Librin si provë para se ai të përgjigjej.⁷⁴ Prokuroria parashtron se në bazë të sa më sipër, dhe duke marrë parasysh qëndrimin e qartë të Haradinajt të shprehur në Letër, është e vështirë të supozohet se Haradinaj do ta kishte kundërshtuar pranueshmërinë e Librit gjatë gjykimit të parë, siç pretendon ai.⁷⁵

16. Prokuroria argumenton se autenticiteti është çështje fakti dhe se fakti që Haradinaj e pranoi autenticitetin dhe pranueshmërinë e Librit si provë përmes avokatit të tij e zgjidh problemin në lidhje me këtë çështje.⁷⁶ Sipas Prokurorisë, duhet bërë dallim nga vendimet e Dhomës së gjykimit të parë mbi çështje të provave, të cilat faktikisht nuk janë detyruese për Dhomën e rigjykimit.⁷⁷

17. Për sa i përket dëshmitares së re që propozohet, Prokuroria parashtron se në kundërshtim me argumentin e Haradinajt se dëshmia e Schnieper-it nuk lidhet me asnjë aspekt tjetër të rigjykimit, Intervista ka lidhje me pika të tjera të rigjykimit, të paraqitura në Mocion.⁷⁸ Prokuroria më tej parashtron se dëshmia e pritshme e dëshmitares tregon që Haradinaj iu referua publikisht Librit si “libri im” shumë kohë para aktakuzës së Tribunalit kundër tij, gjë që vërteton se ai e kishte miratuar dhe pranuar përmbajtjen e tij.⁷⁹ Prokuroria gjithashtu argumenton se dëshmia e pritur e Schnieper-it mund të ndihmojë për të përcaktuar peshën provuese të pjesëve të Librit.⁸⁰ Prokuroria vë në dukje se qëndrimin e tij të ri në lidhje me pranueshmërinë e Librit, Haradinaj e bëri të ditur gjatë ekspozesë hyrëse të Prokurorisë dhe gjatë dëshmisë së Bislim Zyrapit të cilit iu tregua një pjesë e Librit. Për këto arsye, Prokuroria pretendon se ka treguar zellin e duhur kur kërkoi përfshirjen e Schnieper-it në listën e dëshmitarëve të saj në këtë fazë, pas

⁷³ Kundërpërgjigje, para. 5.

⁷⁴ Kundërpërgjigje, para. 6.

⁷⁵ Kundërpërgjigje, para. 6.

⁷⁶ Kundërpërgjigje, para. 7.

⁷⁷ Kundërpërgjigje, para. 8.

⁷⁸ Kundërpërgjigje, para. 9.

⁷⁹ Kundërpërgjigje, para. 9.

⁸⁰ Kundërpërgjigje, para. 9.

marrjes së vendimit për ta kontaktuar dëshmitaren në shtator 2011.⁸¹ Prokuroria më tej parashtron se përfshirja e dëshmitares së re në listën e dëshmitarëve të Prokurorisë nuk do të paragjykonte padrejtësisht Mbrojtjen duke qenë se është kërkesë e vetme e këtij lloji që ka paraqitur Prokuroria gjatë rigjyimit.⁸² Prokuroria më tej parashtron se pranimi i një dëshmitari të vetëm shtesë nuk do të shkelte të drejtën e të Akuzuarve për gjykim të shpejtë, duke qenë se dëshmia që pritet prej dëshmitares nuk do të zgjaste më shumë se një seancë.⁸³

18. Prokuroria më tej argumenton se dokumentet e Rregullës 65ter me numrat 3060-3063 përmbajnë informacion në lidhje me shkakun e vdekjes së Zenun Gashit.⁸⁴ Prokuroria argumenton të kundërtën e parashtrimit të Haradinajt – se dokumentet kanë lidhje me akuzat e paraqitura në Aktakuzë, siç parashtrohet në vendimin e Dhomës të Rregullës 92bis.⁸⁵

III. LIGJI PËRKATËS

A. Lista e dëshmitarëve e Rregullës 65ter

19. Sipas Rregullës 73bis(F) të Rregullores, Dhoma Gjyqësore mund ta miratojë kërkesën e një pale për ndryshimin e listës së dëshmitarëve në qoftë se bindet se është në interesin e drejtësisë.⁸⁶ Megjithatë, Dhoma duhet të garantojë se përfshirja e vonshme e një dëshmitari në listë nuk do të paragjykojë Mbrojtjen.⁸⁷ Në zbatimin e kompetencave të

⁸¹ Kundërpërgjigje, para. 10.

⁸² Kundërpërgjigje, para. 11.

⁸³ Kundërpërgjigje, para. 12.

⁸⁴ Kundërpërgjigje, para. 14.

⁸⁵ Kundërpërgjigje, para. 14 i referohet *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e transkripteve të dëshmimeve në vend të dëshmisë gojore sipas Rregullës 92bis, 22 korrik 2011, para. 24-25, 35, 37, 40.

⁸⁶ *Prokurori k. Gjorgjeviqit*, Lënda nr. IT-05-87ë1-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për leje për ndryshimin e listës së dëshmitarëve të Rregullës 65ter, 14 maj 2009 (“Vendimi Gjorgjeviq”), para. 5; *Prokurori k. Tolimirit*, Lënda Nr. IT-05-88ë2-T, Vendim mbi Mocionet e Prokurorisë në lidhje me listat e dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65te, Rregullës 92ter, dhe masat mbrojtëse, 30 mars 2010, konfidencial, (“Vendimi Tolimir”), para. 9.

⁸⁷ Vendimi Gjorgjeviq, para. 5; *Prokurori k. Karaxhiqit*, Lënda Nr. IT-95-5ë18-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për leje për ndryshimin e listës së dëshmitarëve duke shtuar një dëshmitar në lidhje me faktet, 19 shkurt 2010, konfidencial (“Vendimi Karaxhiq”), para. 5.

saj, Dhoma merr parasysh rëndësinë dhe vlerën provuese *prima facie* të provës apo dëshmisë që propozohet, nëse pala që ka paraqitur provën ka treguar arsye të fortë për ndryshimin, nëse ka treguar zell në identifikimin e dëshmitarit të propozuar, nëse miratimi i kërkesës për ndryshim do të ketë për pasojë zgjatjen e panevojshme të procesit, si dhe fazën e procesit kur bëhet kërkesa.⁸⁸ Çdo padrejtësi e shkaktuar nga koha e ndryshimit të propozuar mund të korrigjohet duke e thirrur dëshmitarin për të dëshmuar në një fazë më të vonshme të gjykimit, për t'i mundësuar Mbrojtjes kohë për t'u përgatitur.⁸⁹

B. Lista e provave materiale e Rregullës 65ter

20. Nëqoftëse bindet se është në interes të drejtësisë dhe duke ushtruar kompetencën e saj të brendaqenësishme lidhur me administrimin e procesit gjyqësor, Dhoma mund të miratojë një kërkesë për ndryshimin e listës së provave materiale të palëve.⁹⁰ Në miratimin e një kërkesë të tillë, Dhoma duhet të vlerësojë me kujdes nëse ndryshimi i listës së provave materiale është në përputhje me garantimin e të drejtave të të akuzuarit dhe në çfarë mase provat e reja krijojnë ngarkesë shtesë për mbrojtjen.⁹¹ Dhoma duhet të bindet se ekziston arsye e fortë për ndryshimin e listës së parë dhe se materiali i ri që ofrohet është i rëndësishëm *prima facie* dhe ka të ngjarë të ketë vlerë provuese në lidhje me akuzat e paraqitura në aktakuzë, dhe është i rëndësishëm në atë masë sa të përligjë përfshirjen e tij të vonshme.⁹²

⁸⁸ Prokurori k. Stanishiqit dhe Simatoviqit, Lënda Nr. IT-03-69-PT, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për ndryshimin e listës së dëshmitarëve të Rregullës 65ter, 27 shkurt 2008, konfidencial, f. 5; Vendimi Gjorgjeviq, para. 5; Vendimi Karaxhiq, para. 5.

⁸⁹ Vendimi Karaxhiq, para. 5.

⁹⁰ Prokurori k. Popoviqit dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-05-88-AR73.1, Vendim mbi Apelimin e Vendimit për pranimin e materialeve lidhur me marrjen në pyetje të Borovçaninit, 14 dhjetor 2007, ("Vendimi i Apelit Popoviq"), para. 37.

⁹¹ Vendimi i Apelit Popoviq, para. 37; Prokurori k. Sheshelit, Lënda Nr. IT-03-67-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për ndryshimin e listës së provave materiale të Rregullës 65ter, 4 mars 2008, konfidencial ("Vendimi Sheshel"), para. 20; Prokurori k. Stanishiqit dhe Simatoviqit, Lënda Nr. IT-03-69-T, Vendim mbi Mocionet njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë dhe trembëdhjetë të Prokurorisë për leje për ndryshimin e listës së provave materiale të Prokurorisë të Rregullës 65ter, 10 shkurt 2010 ("Vendimi Stanishiq dhe Simatoviq"), para. 26.

⁹² Vendimi i Apelit Popoviq, para. 37; Vendimi Sheshel, para. 20; Vendimi Stanishiq dhe Simatoviq, para. 26; Vendimi Tolimir, para. 7-8; krahaso Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Udhëzime për Njoftimet dhe për paraqitjen e provave, 19 gusht 2011 ("Udhëzime"), para. 4.

C. Pranimi i provave sipas Rregullës 92ter

21. Dhoma ka parashtuar ligjin sipas Rregullës 92ter në Vendimin e saj të Rregullës 92ter.⁹³ Dhoma kujton se qëllimi kryesor i Rregullës 92ter është mundësimi i një gjyqi rezultativ dhe të shpejtë duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarit.⁹⁴ Vendimi për pranimin ose mospranimin e provave sipas kësaj Rregulle është tërësisht në kompetencën e Dhomës Gjyqësore.⁹⁵

22. Megjithëse Rregulla 92ter nuk përmend shprehimisht pranimin e provave materiale, jurisprudenca e Tribunalit lejon pranimin e tyre në qoftë se ato shoqërojnë deklaratat me shkrim apo transkriptet e dëshmime gojore të dëshmitarëve.⁹⁶ Për t'u pranuar, provat materiale duhet të jenë "pjesë e pandashme dhe e domosdoshme" e dëshmisë së dëshmitarit.⁹⁷ Për plotësimin e këtij kushti, dëshmia e dëshmitarit në të

⁹³ Prokurori k. *Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e provave sipas Rregullës 92ter, 23 gusht 2011 ("Vendimi i Rregullës 92ter në çështjen *Haradinajt dhe të tjerët*"), para. 27-30.

⁹⁴ Prokurori k. *Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-T, Vendim mbi Zbatimin e Rregullës 92ter të Rregullores, 3 korrik 2007, f. 2; Prokurori k. *Deliqit*, Lënda Nr. IT-04-83-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e deklaratave me shkrim të dëshmitarëve sipas Rregullës 92ter, 27 shtator 2007, Prokurori k. *Stanishiqit dhe Zhuplaninit*, Lënda Nr. IT-08-91-T, Vendim për refuzimin e kërkesës së Stanishiqit për pranimin e dëshmive sipas rregullës 92ter, 20 prill 2011, konfidencial ("Vendimi i Rregullës 92ter në çështjen *Stanishiq dhe Zhuplanin*"), para. 19; Vendimi i Rregullës 92ter në çështjen *Haradinajt dhe të tjerët*, para. 27.

⁹⁵ Prokurori k. *Popoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-88-T, Vendim mbi Mocionin për ndryshimin e statusit të dëshmitarit nga viva voce në dëshmitar të Rregullës 92ter, 31 maj 2007, f. 3; Vendimi i Rregullës 92ter në çështjen *Stanishiq dhe Zhuplanin*, para. 19; Vendimi i Rregullës 92ter në çështjen *Haradinajt dhe të tjerët*, para. 27.

⁹⁶ Prokurori k. *Dragomir Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-98-29/1-T, Vendim mbi pranimin e deklaratave me shkrim, transkripteve dhe provave materiale shoqëruese sipas Rregullës 92bis, 22 shkurt 2007 ("Vendimi *Millosheviq*"), f. 3; Prokurori k. *Millan Llukiqit dhe Sredoje Llukiqit*, Lënda Nr. IT-98-32/1-T, Vendim mbi Mocionin konfidencial të Prokurorisë për pranimin e dëshmisë gojore të mëparshme me provat materiale shoqëruese dhe deklaratat me shkrim të dëshmitarëve sipas Rregullës 92ter, 9 korrik 2008, konfidencial ("Vendimi *Llukiq dhe Llukiq*"), para. 15; Vendimi i Rregullës 92ter në çështjen *Haradinajt dhe të tjerët*, para. 29.

⁹⁷ Prokurori k. *Naletliqit dhe Martinoviqit*, Lënda Nr. IT-98-32/1-PT, Vendim në lidhje me Njoftimin e Prokurorisë për paraqitjen e transkripteve sipas Rregullës 92bis (D) të Rregullores, 9 korrik 2001, para. 8; Prokurori k. *Lubiçiqit*, Lënda Nr. IT-00-41-PT, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e transkripteve të dëshmive sipas Rregullës 92bis(D) të Rregullores, 23 janar 2004, konfidencial, f. 5; Vendimi *Llukiq dhe Llukiq*, para. 15; Vendimi i Rregullës 92ter në çështjen *Haradinajt dhe të tjerët*, para. 29; shih gjithashtu Vendimi *Millosheviq*, f. 3.

vërtetë duhet ta shpjegojë dokumentin dhe dokumenti duhet të jetë i tillë pa të cilin dëshmia e dëshmitarit do të ishte e pakuptimtë apo me vlerë më të vogël provuese.⁹⁸

23. Dëshmia që kërkohet të pranohet sipas Rregullës 92ter, qoftë në formën e deklaratës me shkrim apo të transkriptit të dëshmisë gojore, duhet që gjithashtu të plotësojë kushtet e përgjithshme të pranueshmërisë.⁹⁹ Kjo do të thotë që dëshmia e propozuar duhet të jetë e rëndësishme dhe me vlerë provuese, dhe vlera provuese e saj nuk duhet të zhvlerësohet ndjeshëm prej nevojës për garantimin e një gjykimi të drejtë.¹⁰⁰

D. Pranimi i provave në sallën e gjyqit

24. Pranimi i provave në sallën e gjyqit është praktikë e konsoliduar në jurisprudencën e Tribunalit.¹⁰¹ Sipas Rregullës 89(C) të Rregullores, Dhoma mund të pranojë çfarëdo prove përkatëse të cilën e gjykon me vlerë provuese. Pala që paraqet provën duhet të tregojë qartë dhe në mënyrë konkrete rëndësinë e secilit dokument, si dhe arsyen pse dhe me cilën pjesë të çështjes së saj lidhet dokumenti përkatës.¹⁰² Që një dokument të pranohet si provë mjafton që ai të jetë *sadopak* i rëndësishëm dhe me *sadopak* vlerë provuese.¹⁰³ Sipas Udhëzimeve të Dhomës, Dhoma mund t'u lejojë palëve

⁹⁸ *Prokurori k. Stanishiqit dhe Simatoviqit*, Lënda Nr. IT-03-69-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e deklaratës me shkrim të dëshmitarit Slobodan Lazareviq sipas Rregullës 92ter, me shtojcën konfidenciale, 16 maj 2008, para. 19; Vendimi *Llukiq dhe Llukiq*, para. 15; Prokurori k. Haraqisë dhe Morinës, Lënda Nr. IT-04-84-R77.4, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e dëshmiave sipas Rregullës 92bis dhe/ose 92ter, 2 shtator 2008, konfidencial (“Vendimi *Haraqija dhe Morina*”), para. 12; Vendimi i Rregullës 92ter në çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 29.

⁹⁹ Vendimi *Llukiq dhe Llukiq*, para. 20; Vendimi *Haraqija dhe Morina*, para. 13; Vendimi i Rregullës 92ter në çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 30.

¹⁰⁰ Rregulla 89(C) dhe (D) e Rregullores.

¹⁰¹ *Prokurori k. Karaxhiqit*, Lënda Nr. IT-95-5ë18-T, Vendim mbi Mocionin e parë të Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, 13 prill 2010, para. 5; *Prokurori k. Stanishiqit dhe Zhuplaninit*, Lënda Nr. IT-08-91-T, Vendim për miratimin e pjesshëm të mocionit të Mbrojtjes së Stanishiqit për pranimin e provave në sallën e gjyqit, 15 shtator 2011 (“Vendimi për pranimin e provave në sallën e gjyqit në çështjen *Stanishiq dhe Zhuplanin*”), para. 12.

¹⁰² *Prokurori k. Deliqit*, Lënda Nr. IT-04-83-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e dokumenteve si prova, 9 maj 2008, para. 8; *Prokurori k. Perishiqit*, Lënda Nr. IT-04-81-T, Vendim mbi Mocionin e parë të Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, 5 tetor 2009, konfidencial, para. 20; Vendimi për pranimin e provave në sallën e gjyqit në çështjen *Stanishiq dhe Zhuplanin*, para. 12.

¹⁰³ *Prokurori k. Haxhihasanoviqit dhe Kuburës*, Lënda Nr. IT-01-47-T, Vendim në lidhje me pranueshmërinë e disa dokumenteve të kundërshtuara dhe të dokumenteve për identifikim, 19 gusht 2004, konfidencial (“Vendimi *Haxhihasanoviq dhe Kubura* në lidhje me pranueshmërinë”), para. 55.

paraqitjen e dokumenteve apo sendeve të tjera për pranim si prova materiale në sallën e gjyqit vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe pasi t'i jetë paraqitur arsye e fortë.¹⁰⁴

25. Besueshmëria e dokumentit është faktori kryesor për të përcaktuar nëse janë plotësuar kushti i rëndësisë dhe i vlerës provuese dhe nëse dokumenti është i pranueshëm.¹⁰⁵ Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se për të qenë e pranueshme një provë, duhet të provohet plotësisht besueshmëria e saj; përkundrazi, në fazën e pranimi të provave mjafton që të ketë tregues të mjaftueshëm *prima facie* të besueshmërisë së provës.¹⁰⁶

26. Megjithëse Rregulla 89(C) e Rregullores parashtrohet se dy kushtet për pranimin e provave janë rëndësia dhe vlera provuese, Rregullorja gjithashtu parashtrohet bazën për përjashtimin e provave. Dhoma ruan të drejtën për të vendosur mbi pranimin e provave nëpërmjet paragrafit D të Rregullës 89 sipas të cilës një Dhomë mund të përjashtojë prova nëqoftëse vlera e tyre provuese zhvlerësohet ndjeshëm prej nevojës për garantimin e një gjykimi të drejtë. Për më tepër, sipas Rregullës 95, nuk pranohen provat e siguruar me anë të metodave që krijojnë dyshim thelbësor mbi besueshmërinë e tyre ose nëqoftëse pranimi i tyre nuk është etik dhe komprometon seriozisht procesin.

27. Në vërtetimin e besueshmërisë së një dokumenti, rol mund të luajë autenticiteti i dokumentit, por gjatë fazës së pranimi nuk është e nevojshme që të vërtetohet

¹⁰⁴ Udhëzime, para. 6.

¹⁰⁵ *Prokurori k. Bllagojeviqit dhe Jokiqit*, Lënda Nr. IT-02-60-T, Vendim mbi pranimin si provë të materialeve në lidhje me përgjimet, 18 dhjetor 2003, para. 15; Vendimi *Haxhihasanoviq dhe Kubura* në lidhje me pranueshmërinë, para 55; *Prokurori k. Boshkoskit dhe Tarçullovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin në sallën e gjyqit të provave me shtojcat konfidenciale A deri më E, 14 maj 2007, para. 9; *Prokurori k. Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.13, Vendim mbi Apelimin e ndërkohshëm dhe përmbledhës të Jadranko Përliqit të Urdhrave të Dhomës Gjyqësore të datës 6 dhe 9 tetor 2008 në lidhje me pranimin e provave, 12 janar 2009 (Vendimi i Apelit i datës 12 janar 2009 në çështjen *Përliq dhe të tjerët*), para.15; *Prokurori k. Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.16, Vendim mbi Apelimin e ndërkohshëm dhe përmbledhës të Jadranko Përliqit të Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes së tij për rishikimin e Vendimit për pranimin e provave dokumentare, 3 nëntor 2009 (“Vendimi i Apelit i datës 3 nëntor 2009 në çështjen *Përliq dhe të tjerët*”), para. 33.

¹⁰⁶ Vendimi i Apelit i datës 12 janar 2009 në çështjen *Përliq dhe të tjerët*, para. 15; Vendimi i Apelit i datës 3 nëntor 2009 në çështjen *Përliq dhe të tjerët*, para. 33-34.

autenticiteti i tij.¹⁰⁷ Autenticiteti ka të bëjë me faktin nëse dokumenti është në të vërtetë ashtu siç pretendohet të jetë në lidhje me origjinën dhe autorësinë.¹⁰⁸

IV. DISKUTIM

A. Kërkesë për pranimin e pjesëve të Librit (dokumenti numër 3002 i Rregullës 65ter) në sallën e gjyqit

28. Dhoma vëren se disa nga pjesët e paraqitura të Librit kanë të bëjnë me ngjarjet në Aktakuzë dhe lidhen me këtë çështje, si për shembull ato që përshkruajnë nivelin e organizimit dhe mënyrën e punës të UÇK-së gjatë periudhës së Aktakuzës (si mbledhjet, shqyrtimet e strategjisë, furnizimi me armë, përçarja me FARK-un, betejat, kontrolli mbi territorin), si dhe marrëdhëniet midis të Akuzuarve dhe shkallën e pushtetit të tyre.¹⁰⁹

29. Për sa i përket vlerës provuese të pjesëve të Librit, Dhoma vëren nga vetë parashtrimet e Haradinajt se pjesët e Librit që Prokuroria kërkon t'i paraqesë si provë në sallën e gjyqit, bazohen në një bisedë me të.¹¹⁰ Dhoma më tej vë në dukje se Libri është i shkruar në formë pyetje-përgjigje, me sa duket sipas rrjedhës së një interviste. Megjithatë, për mendimin e Dhomës, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Delvoie, nuk është e qartë se për çfarë qëllimi Haradinaj dha një informacion të tillë gjatë kësaj bisede dhe se pse u shkrua libri – për të treguar të vërtetën apo për mburrje, dhe nëse rrëfimet në të janë ndikuar nga qëllime politike. Për më tepër, Libri përmban thashetheme të shumëfishta që nuk mund të provohen gjatë procesit gjyqësor, dhe informacioni që dha Haradinaj nuk u dha nën betim, apo nuk synohej që një informacion i tillë të përdorej në procese gjyqësore.

¹⁰⁷ Vendimi i Apelit i datës 3 nëntor 2009 në çështjen *Përliq dhe të tjerët*, para. 34; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Arsyetimi i Vendimit për refuzimin e pranimit si provë të dokumentit numër 03003 të Rregullës 65ter, 6 tetor 2011, para. 9.

¹⁰⁸ Vendimi i Apelit i datës 3 nëntor 2009 në çështjen *Përliq dhe të tjerët*, para. 34.

¹⁰⁹ Dokumenti 3002 i Rregullës 65ter, f. 45-62, 71-78, 83-90, 92-94, 96-109, 114-115, 118, *krahaso* Mocioni, Shtojca A, f. 4-14.

¹¹⁰ Përgjigje e Haradinajt, para. 25.

30. Dhoma, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Delvoie, bën të ditur se nuk mori prova që tregonin se autori i Librit, Bardh Hamzaj, kishte paraqitur në mënyrë të saktë mendimet e Haradinajt. Dhoma vëren dedikimin në kopjen e Librit që iu dha Schnieper-it (“Për Marlène Schnieper /?Lanfrancois/, me respekt Ramush Haradinaj, 15 shtator 2001, Prishtinë, Kosovë”),¹¹¹ dhe referimin e vetëm që i bën Haradinaj Librit me “libri im” gjatë Intervistës kur po diskutonte sulmin kundër shtëpisë së tij në mars 1998. Për mendimin e Dhomës, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Delvoie, edhe sikur kopja e nënshkruar e Librit dhe Intervista të merreshin parasysht gjatë vlerësimit të besueshmërisë *prima facie* të pjesëve të paraqitura të Librit, ashtu siç pretendon Prokuroria, asnjë prej tyre nuk tregon se Haradinaj e kishte pranuar përmbajtjen e tërë Librit si e vërteta për çështjet e paraqitura në të. Në rrethana të tilla, shumica e Dhomës nuk bindet se Prokuroria vërtetoi *prima facie* besueshmërinë e pjesëve të paraqitura. Ajo që është më me rëndësi është se shumica është e mendimit se Letra e Haradinajt në të cilën ai, përmes avokatit të tij, pajtohet me autenticitetin dhe pranueshmërinë e Librit, u shkrua gjatë komunikimeve paraprake midis palëve gjatë gjykimit të parë, në përpjekjet e tyre për të gjetur gjuhë të përbashkët në lidhje me faktet e pranuar, dhe mund të jetë ndikuar nga strategjia gjyqësore. Haradinaj kundërshton pranimin e Librit në këtë gjyq. Prokuroria nuk ka ofruar ndonjë dëshmitar që do t’i konfirmonte faktet që përshkruhen në pjesët e paraqitura të Librit, siç u bë me dëshmitarin Bislim Zyrapë përmes të cilit u pranuan si provë dy faqe të Librit.¹¹²

31. Për arsyet e lartpërmendura, shumica, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Delvoie, konkludon se ekziston dyshim i konsiderueshëm në lidhje me besueshmërinë e pjesëve të paraqitura të Librit, se ato nuk e përmbushin kriterin e besueshmërisë *prima facie* dhe rrjedhimisht refuzon pranimin e pjesëve të paraqitura të Librit.

¹¹¹ Dokumenti 3112 i Rregullës 65ter.

¹¹² T. 680-681; P283.

B. Kërkesë për përfshirjen e kopjes së nënshkruar me dedikim të Librit dhe të Letrës (dokumentet numër 3112 dhe 3113 të Rregullës 65ter) në listën e provave materiale të Prokurorisë

32. Prokuroria kërkon përfshirjen e Librit të nënshkruar me dedikim dhe të Letrës në listën e provave materialeve të veta të Rregullës 65bis, për të vërtetuar *prima facie* besueshmërinë e pjesëve të paraqitura të Librit. Rrjedhimisht, rëndësia dhe vlera provuese e kopjes së nënshkruar me dedikim të Librit dhe e Letrës mund të shërbejnë vetëm për të përcaktuar nëse pjesët e paraqitura të Librit mund të pranohen ose jo si prova materiale. Për arsyet e lartpërmendura, shumica me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Delvoie, refuzon pranimin e pjesëve të paraqitura të Librit si provë. Për këtë arsye, Shumica konkludon se kopja e nënshkruar me dedikim e Librit dhe Letra nuk plotësojnë *prima facie* kushtin e rëndësisë dhe të vlerës provuese për t'u përfshirë në listën e provave materiale të Prokurorisë të Rregullës 65ter dhe rrjedhimisht hedh poshtë këto kërkesa të Prokurorisë.

C. Kërkesë për përfshirjen e Schnieper-it në listën e dëshmitarëve të Prokurorisë

33. Dëshmia që pritët prej Schnieper-it konfirmon se ajo e intervistoi Ramush Haradinajn. Dhoma vëren se pjesë të mëdha të kësaj Interviste janë në lidhje me periudhën para ose pas Aktakuzës dhe, midis të tjerash, me biografinë e Haradinajt para luftës, apo me ambiciet e tij politike të pasluftës, dhe me vitet e para të themelimit të UÇK-së, duke filluar nga 1994 e më pas, dhe nuk lidhen me çështjet e paraqitura në Aktakuzë.¹¹³ Vetëm disa pjesë të Intervistës janë të rëndësishme, gjegjësisht ato në lidhje me përgatitjen ushtarake të Haradinajt, hyrjen e tij në Kosovë më 1998, sulmin kundër vendbanimit të familjes së tij më 24 mars 1998, rolin e tij si komandant dhe hollësi të tjera nga lufta në vitin 1998.¹¹⁴ Edhe sikur dëshmia që pritët prej Schnieper-it të ishte e rëndësishme në lidhje me këto pjesë të caktuara të Intervistës, shumica është e mendimit

¹¹³ Dokumenti numër 3000 i Rregullës 65ter, f. 1-19, 23-24.

¹¹⁴ Dokumenti numër 3000 i Rregullës 65ter, f. 20-22.

se këto pjesë të caktuara të intervistës nuk janë të rëndësishme në atë masë sa të justifikojnë përfshirjen e dëshmitares në listën e dëshmitarëve të Prokurorisë në këtë fazë të vonshme.¹¹⁵ Dhoma më tej ka parasysh faktin se Prokuroria dinte për Schnieper-in që prej vitit 2005¹¹⁶ dhe se gjatë gjykimit të parë ajo i kishte dhënë Prokurorisë deklaratë.¹¹⁷ Megjithatë Prokuroria shpjegon arsyen për përfshirjen me vonesë të dëshmitares në listën e vet të dëshmitarëve, ky shpjegim ka të bëjë vetëm me dëshminë që pritet prej dëshmitares në lidhje me Librin. Për mendimin e Shumicës, ky shpjegimi nuk është bindës, për arsye se Prokuroria nuk mund të shfrytëzonte qëndrimin e Mbrojtjes gjatë bisedimeve “të paparagjykuara” midis palëve para fillimit të gjykimit të parë për supozimin se Mbrojtja nuk do të kundërshtonte pranimin e Librit në këtë proces. Lidhur me këtë pikë, Dhoma kujton argumentin e Haradinajt se ai e kishte bërë të qartë qëndrimin e tij në lidhje me pranimin e Librit në dosjen e tij paragjyqësore të dorëzuar më 11 korrik 2011.¹¹⁸ Nuk jepet shpjegim për përfshirjen me vonesë të Schnieper-it në listën e dëshmitarëve të Prokurorisë lidhur me pjesët e tjera të dëshmisë që pritet prej saj. Në rrethana të tilla, shumica konkludon se Prokuroria nuk tregoi zellin e duhur kujdesshme e as nuk paraqiti arsye bindëse për ndryshimet e kërkuara të listës së saj të dëshmitarëve në këtë fazë të procesit gjyqësor.

34. Për arsyet e lartpërmendura, shumica hedh poshtë kërkesën e Prokurorisë për përfshirjen e dëshmitares së propozuar në listën e dëshmitarëve të Rregullës 65ter dhe për paraqitjen e dëshmisë së saj sipas Rregullës 92ter(A).

D. Kërkesë alternative për pranimin e Intervistës (dokumenti numër 3000 i Rregullës 65ter) në sallën e gjyqit

35. Siç u theksua më lart, shumica, me përjashtim të gjykatësit Delvoie, gjykon se pjesa me e madhe e Intervistës nuk ka lidhje me çështjen, dhe se pjesët e tjera të Intervistës nuk kanë vlerë të konsiderueshme provuese që do të përligjte pranimin e saj.

¹¹⁵ Shih Vendimi i Apelit *Popoviq*, para. 37.

¹¹⁶ Shih Përgjigjja e Haradinajt, para. 21.

¹¹⁷ Shih Mocioni, para. 29.

¹¹⁸ Përgjigjja e Haradinajt, para. 21.

Në këtë pikë, shumica, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Delvoie, gjykon se nuk dihet qëllimi i përgjigjeve të dhëna dhe nëse ato u dhanë për qëllime politike, për mburrje, për propagandë, apo për të treguar të vërtetën, dhe për këtë arsye refuzon pranimin e Intervistës si provë materiale.

E. Kërkesa për rishikimin dhe plotësimin e dokumentacionit të KNKK-së (materiali numër 1276 i Rregullës 65ter) në listën e provave të Prokurorisë dhe për pranimin e dokumentacionit mjeko-ligjor (dokumentet numër 1276, 3060-3063 të Rregullës 65ter) në sallën e gjyqit

36. Dhoma tani do të shqyrtojë kërkesën e Prokurorisë për rishikimin dhe plotësimin e dokumentacionit të KNKK-së (materiali numër 1276 i Rregullës 65ter) në listën e saj të provave dhe për pranimin e këtij materiali dhe të dokumentacionit mjeko-ligjor (dokumentet numër 1276, 3060-3063 të Rregullës 65ter) si prova materiale në sallën e gjyqit. Dhoma gjykon se rishikimi i propozuar i dokumentacionit të KNKK-së (materiali numër 1276 i Rregullës 65ter) nuk do të paragjykojë të Akuzuarit, për arsye se Mbrojtja disponon me informacionin se Ivan Zariqi dhe Agron Berisha ende konsiderohen të zhdukur dhe ky informacion nuk ka ndryshuar.¹¹⁹ Plotësimi dhe rishikimi i propozuar i materialit numër 1276 të Rregullës 65ter nuk do t'i paragjykojë padrejtësisht të Akuzuarit, për arsye se informacioni që Ivan Zariqi, Agron Berisha, Nesret Alijaj, Burim Bejta dhe Ukë Rexhepaj ende konsiderohen të zhdukur konfirmohet nga prova të tjera që ka marrë Dhoma.¹²⁰ Materiali numër 1276 i Rregullës 65ter përfshin dokumente të marra nga faqja e internetit e KNKK-së të cilat konfirmojnë se pesë viktimat e lartpërmendura, emrat e të cilëve përmenden në Pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës, ende konsiderohen të zhdukur dhe përmbajnë datën dhe vendin ku janë parë për herë të fundit. Këto dokumente kanë lidhje me pikat e Aktakuzës. Materiali numër 3060-3063 i Rregullës 65ter përfshin dokumente mjeko-ligjore të marra nga UNMIK-u, të cilat konfirmojnë shkakun e vdekjes së Zenun Gashit, vdekja e të cilit mund të jetë e rëndësishme në vërtetimin e qëllimit të

¹¹⁹ Shih Mocioni, para. 24.

¹²⁰ Provat materiale P1; P105, P107, P286; shih Mocioni, para. 24; Përgjigja e Haradinajt, para. 33.

përbashkët të NPK-së së pretenduar në Aktakuzë.¹²¹ Dhoma vëren se faqja 3 e dokumentit numër 3060 të Rregullës 65ter, faqja 3 e dokumentit numër 3062 të Rregullës 65ter dhe faqet 4 dhe 5 të dokumentit numër 3063 të Rregullës 65ter kanë të bëjnë me Pal Krasniqin, për të cilin palët kanë pranuar disa fakte mjeko-ligjore, dhe për këtë arsye nuk është e nevojshme që këto faqe të pranohen. Dokumentet e paraqitura (dokumentet numër 1276, 3060-3063 të Rregullës 65ter) duken të besueshme: ato vijnë nga burime zyrtare, mbajnë datë, nënshkrim dhe vulë, apo mbështeten nga prova të tjera. Këto dokumente kanë vlerë të mjaftueshme provuese.

37. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma miraton kërkesën e Prokurorisë për rishikimin dhe plotësimin e dokumentacionit të KNKK-së (materiali numër 1276 i Rregullës 65teri) në listën e saj të provave materiale dhe pranon këtë material si dhe dokumentacionin mjeko-ligjor (dokumentet numër 1276, 3060 (me përjashtim të faqes 3), 3061, 3062 (me përjashtim të faqes 3) dhe 3063 (me përjashtim të faqeve 4 dhe 5) të Rregullës 65ter) si prova materiale në sallën e gjyqit.

V. VENDIM

Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma

- a. **MIRATON** kërkesën e Prokurorisë dhe të Haradinajt për tejkalimin e kufizimit të numrit të fjalëve;
- b. **MIRATON** kërkesën e Prokurorisë për leje për kundërpërgjigje dhe merr shënim përmbajtjen e kundërpërgjigjes;
- c. **MIRATON** kërkesën e Prokurorisë për rishikimin dhe plotësimin e dokumentacionit të KNKK-së (materiali numër 1276 i Rregullës 65ter);

¹²¹ *Shih Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e transkripteve të dëshmive në vend të dëshmisë gojore sipas Rregullës 92bis, 22 korrik 2011, para. 23-25.

- d. **PRANON** si prova të paraqitura në sallën e gjyqit dokumentet e Rregullës 65ter numër 1276, 3060 (me përjashtim të faqes 3), 3061, 3062 (me përjashtim të faqes 3) dhe 3063 (me përjashtim të faqeve 4 dhe 5), dhe **REFUZON** pranimin e pjesës tjetër të dokumenteve numër 3060, 3062 dhe 3063; dhe
- e. **UDHËZON** Sekretarinë që dokumenteve të pranuar t'u caktojë numra provash.

Për arsyet e lartpërmendura, shumica e Dhomës, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Delvoie,

- f. **REFUZON** kërkesën e Prokurorisë për pranimin si provë të pjesëve të Librit (dokumenti numër 3002 i Rregullës 65ter);
- g. **REFUZON** kërkesën e Prokurorisë për përfshirjen e kopjes së nënshkruar me dedikim të Librit dhe të Letrës (dokumentet numër 3112 dhe 3113 të Rregullës 65ter) në Listën e saj të provave materiale të Rregullës 65 ter;
- h. **REFUZON** kërkesën e Prokurorisë për përfshirjen e Schnieper-it në listën e saj të dëshmitarëve të Rregullës 65ter dhe për thirrjen e dëshmitares për të dëshmuar sipas Rregullës 92ter(A) të Rregullores; dhe
- i. **REFUZON** kërkesën e Prokurorisë për pranimin e Intervistës.

Gjykatësi Delvoie do të bashkëngjisë mendimin e tij mospajtues.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më datën 26 janar 2012.
Në Hagë

Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]